

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Winter 12-2016

OBJEKT SHOQËROR – SHKOLLË FILLORE

Brilantina Bekteshi

University for Business and Technology - UBT

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Architecture Commons](#)

Recommended Citation

Bekteshi, Brilantina, "OBJEKT SHOQËROR – SHKOLLË FILLORE" (2016). *Theses and Dissertations*. 998. <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/998>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.



Fakulteti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapsinor

Punim Diplome
Viti Akademik 2011-2012

Brilantina Bekteshi

OBJEKT SHOQËROR – SHKOLLË FILLORE

Mentori: Prof. Dr. Lulzim Beqiri

Dhjetor 2016

Prishtinë

Lista e figurave

Fig.1.Harta e qytetit te Ferizajit.....	
Fig.2.Harta e komunes se Ferizajit.....	
Fig.3.Pozita e shkolles ne nje rreze prej 600m.....	
Fig.4.Situacioni- qasja ne shkolle.....	
Fig.5.Etazhiteti.....	
Fig.6.Alucobond colors.....	
Fig.7.Alucobond.....	

Përmbajtja

1.0. Pershkrimi i qytetit te Ferizajit.....	4
1.1.Historia.....	4
1.2.Popullsia.....	4
2.0.Pershkrimi i shkolles si institucion arsimor.....	5
2.1.Historiku i shkollave ne Kosove.....	6
2.2.Arsimi sot ne Kosove.....	7
2.2.1.Sistemi i arsimit ne Kosove.....	7
2.2.2.Arsimi ne komunen e Ferizaj-it.....	8
3.0. Lokacioni-gjendja egzistuese.....	9
3.1.Mangesite e lokacionit egzistues.....	9
3.2.Perparsite e lokacionit.....	10
4.0.Lokacioni-casja.....	11
5.0.Etazhiteti.....	12
6.0.Konstruksioni i objektit.....	13
7.0.Ndarja e njesive.....	14
8.0.Materialet.....	15
8.1.Instalimet.....	16
8.1.1.Ngrohja.....	16
8.1.2.Mbrojtja nga zjarri.....	16

Referencat

2.0.PJESA GRAFIKE.....	
2.1. Lokacioni	
2.2.Situacioni	
2.3. Baza e themeleve.....	
2.4. Baza e bodrumit	
2.5. Baza e përdhesës.....	
2.6. Baza e salles se sportit.....	
2.7. Baza e katit I	
2.8. Fasada e pestë	
2.9. Prerjet.....	
2.10. Detalet	
2.11.Fasada I , II	
2.12.Fasada III , IV	
2.13.Prespektiva.....	

Hyrje

1.0 Pershkrimi i qytetit te Ferizaj-it

Ferizaj shtrihet në jug të pjesës qendrore të Kosovës. Paraqet një udhëkryq të rëndësishëm, sepse nëpër Ferizaj kalojnë të gjitha rrugët e rëndësishme që e përshkojnë Kosovën nga veriu në jug dhe nga lindja në perëndim. Këto rrugë pastaj vazhdojnë edhe në shtetet fqinje dhe në rajon.




Fig.1.Harta e qytetit te Ferizaj-it

1.1.Historia

Ka filluar të zhvillohet prej vitit 1873, kur këtu u ndërtua hekurudha dhe stacioni hekurudhor. Në atë kohë këtu ekzistonte një han (bujtinë), pronar i të cilit ka qenë Feriz Shashivari. Ferizaj e ka marrë emrin sipas pronarit të këtij hani.

1.2.Popullsia

Komuna e Ferizajt ka 720 km katrorë, ka gjithsejtë 44 fshatra, në të cilat jetojnë gjysma e popullatës së kësaj komune.

Ferizaj është një qytet relativisht i ri. Ka filluar të zhvillohet prej vitit 1873, kur këtu u ndërtua hekurudha dhe stacioni hekurudhor.

2.0.Pershkrimi i shkolles si institucion arsimor

Një shkollë është një institucion i projektuar për mësimin e nxënësve nën drejtimin e mësuesve. Shkolla u siguron të gjithë fëmijëve të drejtën themelore për arsim dhe mundësi të barabarta pa dallim të origjinës, identitetit kulturor, gjuhës, aftësive, apo rrethanave ekonomike, respektim të vlerave e shoqërisë, të bashkëjetesës në shoqëri, si dhe të qenit qytetar aktiv në botën e ndërvarur.

Shumica e vendeve kanë sisteme të arsimit formal, i cili zakonisht është i detyrueshëm. Emrat për këto shkolla ndryshojnë nga vendi në vend, por në përgjithësi përfshijnë shkollën fillore për fëmijët e vegjël dhe të shkollave të mesme për të rinj që kanë përfunduar arsimin fillor.

Një institucion arsimor i arsimit të lartë është zakonisht një shkollë e lartë, kolegji apo universitet. Përveç këtyre shkollave kryesore, nxënësit në një vend të caktuar mund të ndjekin shkollat para dhe pas arsimit fillor dhe të mesëm. Kopshti ose arsimiti parashkollor janë institucione edukative dhe arsimore për fëmijët shumë të vegjël (zakonisht mosha 3-5).

Universiteti, shkolla profesionale, kolegji apo seminari mund të jenë në dispozicion pas shkollës së mesme. Një shkollë gjithashtu mund të jetë e dedikuar për një fushë të veçantë, të tilla si shkollat e ekonomisë apo shkollat e vallëzimit. Shkollat alternative mund të japin program me mësim jotradicional.

Ka edhe shkolla jo-qeveritare, shkollat e ashtuquajtura "shkolla private". Shkollat private mund të kërkohen kur qeveria nuk ka organizim adekuat të arsimit. Shkollat tjera private gjithashtu mund të jenë fetare, të tilla si shkollat e krishtera, hawzas, yeshivas, kuranore etj, apo shkolla që kanë një standard më të lartë të arsimit ose edhe të atilla që kërkojnë të nxisin arritje të tjera personale. Shkolla për të rriturit përfshijnë institucionet e trajnimit të korporatave, arsimit dhe trajnimit ushtarak dhe të biznesit, pra shkolla profesionale. Në shkollat homeschooling dhe online, mësimdhënia dhe të nxënësve zhvillohet jashtë një ndërtesë tradicionale shkollore. Për çdo fëmijë që meson në shkollë i duket vetja si një zbulues që noton në oqeanin e mesimeve dhe të diturisë. Shkollat janë edhe institucione që mbështesin demokracinë, ku nxënësit mesojnë për vlerat demokratike, patriotizmin dhe marrin kulturë e njohuri shkencore.

2.1.Historiku i shkollave ne Kosove

Është vështirë të vërtetohet me saktësi se kur u themeluan shkollat e para dhe se kur filloi të zhvillohet sistemi i arsimit në trevat shqiptare, por me rëndësi është se format e para të mësimi të organizuar në institucione arsimore shënohen qysh në kohën e Ilirisë së lashtë. Sistemi i arsimit në ilirinë e lashtë, përfshinte në procesin arsimor, disa grupmosha të fëmijve dhe të rriturve.

Marrë në tërësi, zhvillimin e arsimit në Kosovë prej Luftës së Dytë Botërore e deri më sot mund ta ndajmë në pesë etapa kryesore:

Etapa e parë (1944 – 1966). Sistem arsimor socialist me përfshirje gjithë popullore për zhdukjen e analfabetizmit.

Etapa e dytë (1966 – 1980). Shënohet një demokratizim i sistemit të arsimit dhe konsolidimi i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet. Fillojnë punën edhe shkollat e mesme profesionale. Arritjen më të madhe në këtë etapë e paraqet themelimi i Universitetit të Prishtinës.

Etapa e tretë (1980 – 1991). Rikthimi i ndikimit të politikës në arsim, humbja e orientimit arsimor të institucioneve, ndjekja dhe përjashtimi nga puna i ekspertëve dhe mësimdhënësve, zbatimi i politikës antiarsimore dhe antinjerëzore të pushtetit serb.

Etapa e katërt (1991 – 1999). Krijimi i sistemit të pavarur demokratik arsimor dhe ruajtjen e vazhdimësisë së punës së institucioneve arsimore dhe procesit arsimor nën okupim. Gjatë kësaj etape, sistemi arsimor në Kosovë përfshinte: 452 shkolla të plota fillore, 67 shkolla të mesme, 1 universitet me 14 fakultete dhe 7 shkolla të larta, me afro 400.000 nxënës e studentë dhe me 21.000 punëtorë të arsimit.

Etapa e pestë (1999 e deri sot). Reformimi i plotë i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare. Qëllimet arsimore në ndërtimin e aftësive mendore, shkathhtësitë profesionale, kulturën qytetare dhe mirëqenien individuale e shoqërore të qytetarëve të Kosovës.

2.2.Arsimi sot ne Kosove

Nga viti 1999 deri më 2006 nga buxheti i Kosovës janë riparuar 39 objekte shkollore dhe janë ndërtuar 28 objekte të reja. Sipas MASHT, llogaritet se Kosovës i nevojiten së paku edhe 30 objekte të reja dhe riparimi i shumë objekteve të tjera, gjendja e të cilave nuk u përshtatet normave për zhvillimin e procesit arsimor.

2.2.1.Sistemi i arsimit ne Kosove

Sistemi aktual i arsimit në Kosovë ngërthen në vete këto nivele të arsimit:

Arsimi parashkollor - parafillor i cili përfshin tri nivele:

Çerdhja (për fëmijët e moshës 1-2 vjeçare),

Kopshti (për fëmijët e moshës 3-4 vjeçare) dhe

Klasa parafillore (për fëmijët e moshës 5 vjeçare),

Arsimi fillor (pesëklasor) - shkalla 1 sipas ISCED, (kl. I - V) dhe përfshin fëmijët e moshës 6 - 11 vjeç.

Arsimi i mesëm - ngërthen të rinjtë nga mosha 11 - 18 vjeç, me dy nivele:

Arsimi i mesëm i ulët (katërvjeçar), shkalla 2 sipas ISCED, (mosha 11 - 15 vjeç)

Arsimi i mesëm i lartë (tre dhe katërvjeçar), shkalla 3 sipas ISCED, (mosha 15 - 18 vjeç)

Arsimi universitar me tri nivele studimi:

Shkalla e parë - Bachelor

Shkalla e dytë - Master (MA) dhe

Shkalla e tretë - Doktoraturë (Ph.D.)

2.2.2.Arsimi ne komunen e Ferizaj-it

Arsimin Ferizajas e përbëjnë këto nivele:

- I. Parashkollor janë: 2189 fëmijë;
- II. Shkolla fillore janë: 12254 nxënës;
- III. Shkolla e Mesme e Ulët (klasat e 6 – 9) janë: 8779 nxënës ;
- IV. Shkollat e mesme : 8160 nxënës dhe
- V. Fakulteti i Shkencave Aplikative i cili numëron mbi 270 student si dhe
- VI. Kolegji privat ‘‘Aga Xhite’’. i cili numëron diku 110 nxënës.

Gjithësej numëron 31762 nxënës; me

Gjithësej punëtorë 1780 duke përfshirë edhe punëtorët administrativ e teknik- ndihmës dhe udhëheqës të shkollave.

3.0. Lokacioni-gjendja egzistuese

Lokacioni per ndertimin e projektit 'Shkolle fillore' gjendet ne fshatin Zllatar te Komunes se Ferizajit.

Fshati Zllatar gjendet 10 km larg Komunes se Ferizajit.



Fig2.Harta e komunes se Ferizajit

Fshati Zllatar ka diku rreth 1220 banore, ku prej tyre gjithsej ne shkolle jane te regjistruar 121 nxenes te gjinise mashkullore dhe 115 nxenes te gjinise femerore. Ne kete vit te ri akademik jane regjistruar 9 nxenes te gjinise mashkullore dhe 12 nxenes te gjinise femerore.

Ne baze te ketyre analizave duhet te projektohet nje shkolle me kapacitet prej 150 nxenes 9

Lokacioni ku do te projektohet shkolla fillore gjendet ne nje rreze prej 600m ku perfshin pothuajse te gjitha shtepite e fshatit.




Fig3.Pozita e shkolles ne nje rreze prej 600 m.

3.1.Mangesite e lokacionit:

Si mangesi kryesore eshte kyqja ne lokacioni e cila behet nga rruga kryesore dhe nuk ka rruge dytesore.

Mungojne trotuaret e rruges ku femijet duhet te ecin neper skaje te rruges gje qe eshte e rrezikshme per ta.

3.2.Perparesite e lokacionit:

Parcela ku mendohet te realizohet projekti gjendet ne nje rruge dytesore te fshatit e cila eshte e asfaltuar dhe mundeson qasje te lehte ne parcele.

Terreni eshte kryesisht i rrafshet.

Siperfaqja e parces eshte dikun rreth 40 ari.

Per momentin gjendet shkolla egzistuese '4 Prilli' e cila do te rrenohet pas ndertimit te shkolles se re.

4.0.Lokacioni-Çasja

Ne lokacionin te cilin e kemi zgjedhur do te behet projektimi per ndertimin e shkolles fillore. Zgjedhja arkitektonike e objektit ose forma e objektit është kryesisht si rezultat i funksionit të brendshëm dhe idesë së arkitekturës të cilën e kemi menduar.

Hyrja ne parcele behet nga rruga kryesore. Perparesi e pozicionimit te shkolles ne kete menyre eshte se gjitha kyqjet ne parcele behen nga rruga kryesore. Parcela ka gjelberim te mjaftueshem Mbrapa shkolles eshte salla e sportit, e cila perveq nxeneseve te shkolles mund te perdoret edhe nga te tjeret jasht orarit te shkolles dhe ne ditet e pushimeve, gjithmone me nje lejehyrje.

Duke marre parasysh etazhitetin e shtepive dhe objekteve perreth shkolles, eshte vendosur qe etazhiteti i shkolles te jete B+P+1.

Orientimi i klasave eshte bere ne pjesen jugore.




Fig.4.Situacioni-qasja e shkolles

5.0.Etazhiteti

Duke marrë parasysh shtepite dhe objektet përreth, në mënyrë që të jetë në harmonizim me rrethinën është vendosur që objekti të jetë me etazhitet B+P+1.

Bodrumi, përdhësa kanë lartësi 3.40m ndërsa bodrumi 2.80m dysheme-dysheme.

Mbrenda objektit janë shkallet dhe ashensori për në katin e parë.




Fig.5.Etazhiteti

Objekti do të jetë me etazhitet P+5 për 184 persona, do të jetë i pajisur me ashensorë, shkallet e brendshme do të shërbejnë edhe si shkallë kundër zjarrit.

Muret anësore të shkallëve janë prej betonit të armuar i cili reziston deri në një orë e gjysmë ndaj zjarrit.

6.0.Konstruksioni I objektit

Themelet:

Themelet e objektit jane 'themel-shiritore'.

Sistemi Konstruktiv:

Objekti është i projektuar në sistem Skeletor,me shtylla beton-arme me dimensione 30x30cm.

Konstruksioni i meskatit do të jetë masiv pllakë betonë-arme me trashesi H=30cm.

Konstruksioni i kulmit, kulm i rrafshët i shfrytëzueshëm më pjerrtësi 2%,i izoluar sipas normave dhe standardeve teknike .

Muret:

Muret e jashtme janë me trashësi 25 cm me blloka të argjiles gjysem giter të trajtuara nga ana e mbrendshme me llaq dhe gletim kurse nga ana e jashtme me veshje me termofasadë prej stiroporit të presuar,ndërsa muret e brendshme janë me trashësi 20cm dhe 12 cm.

7.0.Ndarja e njesive

Siperfaqja:

1 klase.....	65.8 m2
Hapesira per shumeqellime	353.8 m2
Salla e arsimitareve	70 m2
Kuzhina e per ngrenje e nxenesve.....	85.4 m2
Kuzhina per pergaditje	49 m2
Libraria (biblioteka).....	74.4 m2
Zyrja per informime	49 m2
Salla e arsimitareve ne katin 1	70 m2
Kabineti per fizike	65.1 m2
Kabniteti per kimi	65.1 m2
Kabineti I muzikes	48.5 m2
Salla e kompjutereve	78.4 m2
Zyrja e drejtorit	24.5 m2
Zyrja e sekretarit	12 m2
Zyrja e psikologut	12 m2
Kuzhina e arsimitareve	49 m2

8.0. Materialet

Materiali i cili eshte perdorur ne fasaden e jashtme eshte kryesisht Alucobond me ngjyra te ndryshme te cilat jane ne harmoni me njera tjetren.



Fig.6. Alucobond colors



Fig.7. Alucobond

Materialet tjera te cilat jane perdorur ne objekt jane:

Epoxit- Sipërfaqja e Dyshemes në korridore, klasa dhe kabinete do të jetë e mbuluar me kete material.

Qeramika- Nyjet sanitare dhe kthinat teknike do të jenë të mbuluara me Qeramikë.

Betoni arme, betoni i thjesht. Xhami, plastika etj.

Materialet te cilat jane perdorur ne kulm: shtresat e hidroizolimit dhe termoizolimit, si dhe mbrojtja e këtyre shtresave me materialet e nevojshme për mbrojtjen e tyre.

Pjesa qendrore e kulmit do jetë atrium i mbuluar me qelq 2 shtresor, rezistent nga te gjitha kushteve atmosferike dhe goditjeve.

8.1.Instalimet

Instalimet janë projektuar si projekte në veti për secilin lloj instalimi dhe sipas rregullave në fuqi.

Para fillimit të punimeve do të studiohen dhe përpunohen të gjitha fazat e projektit.

Paramasat e punimeve ndërtimore dhe zejtare do të punohen sipas të gjitha normave dhe rregullave në fuqi. Të gjitha punimet e parapara në paramasë, do të kryhen në mënyrë kualitative sipas normave ndërtimore, standardeve dhe rregullave teknike në fuqi, planeve dhe detaleve të dhëna.

8.1.1. Ngohja:

Rrjeti i ngrohjes do të jete ngrohje qendrore , kaldaj e të cilës do të vendoset në bodrum në hapsirën e veqant të ndarë për ngrohje qendrore.

8.1.2.Mbrojtja nga zjarri

Objekti ka shkallet emergjente ne rast te zjarrit. Mbrenda objektit gjenden aparate te dores per fikjen e zjarrit. Konstruksioni i meskatit dhe muret tek sektoret e rrezikut jane zjarreqendruese per mbi 2 ore.

Referencat:

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj/>

<http://masht.rks-gov.net/arsimi-1>

https://www.google.com/search?q=harta+e+ferizajit&rlz=1C1CHZL_enXK700XK700&espv=2&biw=1536&bih=719&tbm=isch&imgil=-92GHTn9vUP4fM%253A%253Ba3beLSwsjm4WGM%253Bhttp%25253A%25252F%25252Fshqipet.eu%25252Fportal%25252Findex.php%25253Fuser%25252F21213-%25252525C3%25252525B0%25252525C3%25252525A8m%25252525C3%25252525AF%25252525C3%25252525B1%25252525C3%25252525A8r%25252525C3%25252525AF-fr%25252F&source=iu&pf=m&fir=-92GHTn9vUP4fM%253A%252Ca3beLSwsjm4WGM%252C &usg=__C2JerApF2F9oC8ZgahNbfZKRS4M%3D&ved=0ahUKEwjD5_qJ-8vQAhVoP5oKHVAfBZcQyjcIKw&ei=bmc8WMP4Iej-6ATQvpS4CQ#imgrc=-92GHTn9vUP4fM%3A

Nëntor,2016